



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, më 12 tetor 2023 vendosi të modifikojë dënimin e z. Hysni Gucati për lirimin e tij në bazë të disa kushteve. Këto kushte do të jenë në fuqi gjatë pjesës së mbetur të dënimit të dhënë nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Z. Gucati mbërriti në Kosovë më 17 tetor 2023.

Po më 12 tetor, Kryetarja vendosi se do të shqyrtojë modifikimin e dënimit të z. Nasim Haradinaj pasi të ketë marrë një raport nga Administratorja, Fidelma Donlon, lidhur me sjelljen e z. Haradinaj gjatë qëndrimit të tij në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Ndonëse, Kryetarja mori parasysh një sërë faktorësh që mund të jenë në favor të modifikimit të dënimit, ajo thekson se z. Haradinaj ka precedentë disiplinorë në Njësinë e Paraburgimit. Për këtë arsye Kryetarja urdhëroi Administratoren që të paraqesë raport në lidhje me sjelljen e Haradinajt në NJP në të ardhmen brenda një periudhe të caktuar, në kontekst të vendimit mbi modifikimin e dënimit të tij.

Më 12 tetor 2023, versionet e redaktuara publike të aktakuzave të konfirmuara kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit, që mbajnë datën 2 tetor, u bënë publike, të pasuara nga versioni i redaktuar publik i vendimit në lidhje me fletarrestimet dhe urdhrat për transferim më 13 tetor.

Më 12 tetor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi që gjuha e punës në këtë çështje gjyqësore do jetë anglishtja, me pëlqimin e të gjitha palëve. Për këtë arsye, palët dhe pjesëmarrësit do t'i dorëzojnë parashtrimet e protokolluara në anglishte. Në qoftë se shtojcat, materialet mbështetëse ose provat e tjera të palëve janë në një gjuhë tjetër nga anglishtja, atëherë duhet të bëhet përkthimi i tyre. Parashtrimet e protokolluara dhe materialet e tjera do të përkthehen në gjuhët zyrtare të Gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte në përputhje me kriteret e përkthimit sipas Ligjit dhe Rregullores së Procedurës dhe Provave.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi dhe të bashkakuarit*, Trupi Gjyqësor, më 16 tetor urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Trupi Gjyqësor vëren se në fazën në të cilën ndodhet procesi gjyqësor, nxirren në mënyrë të vazhdueshme emra dhe të dhëna të ndjeshme të dëshmitarëve për të akuzuarit. Trupi Gjyqësor theksoi më tej atmosferën e vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe të ndërhyrjes në procese penale kundër ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për këtë arsye, Trupi Gjyqësor doli në përfundimin se ekziston ende rreziku që z. Thaçi dhe z. Veseli të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor dhe/ose të kryejnë krime të tjera. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor konstatoi se vetëm nëpërmjet rregullave në fuqi për monitorimin e komunikimeve në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara mund të kufizohen komunikimet e tyre për të zvogëluar këto rreziqe.





Gjatë kësaj jave, dëshmitari i 29-të dhe 30-të dhanë dëshmi në këtë çështje gjyqësore. Të dy dëshmitarët dhanë dëshmi me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë private.

Seancat gjyqësore në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë* do të rinisin të hënën, më 30 tetor në orën 9:00 të mëngjesit.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, Paneli i Apelit më 12 tetor lëshoi urdhër për përgatitjen e seancës së apelit që është planifikuar të mbahet më 26 dhe 27 tetor. Për të shfrytëzuar sa më mirë kohën gjatë seancës, Paneli i ftoi palët të trajtojnë aspekte konkrete gjatë parashtrimeve gojore. Palët kujtohen gjithashtu të përqendrojnë parashtrimet e tyre te pikat e apelit.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, versioni publik i Vendimit mbi Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm të z. Shala për Arsye Humanitare, i datës 17 gusht, u bë publik. Trupi Gjykues e rrëzoi kërkesën me arsyetimin se Mbrojtja e z. Shala nuk paraqiti informacion thelbësor për këtë vendim. Sidoqoftë, Trupi Gjykues theksoi se ky vendim nuk paragjykon kërkesa të ngjashme që Mbrojtja mund të dorëzojë në të ardhmen.

Seanca vijuese në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënën, 23 tetor në orën 9:30 të mëngjesit.

Të gjitha parashtrimet e protokolluara publike dhe vendimet që përmenden këtu gjenden në faqen e internetit të DHSK-së.

Dje, Zyra e Prokurorit të Specializuar njoftoi se Prokurorja e Specializuar, Kimberli Uest, nënshkroi deklaratën solemne se do t'i kryejë funksionet e saj në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të ndërgjegjshme. Znj. Uest është Prokurori i tretë i Specializuar, pas Xhek Smithit që shërbeu si Prokuror i Specializuar nga 2018 deri më 2022 dhe David Shvendimanit, që shërbeu nga 2016 deri më 2018.

Deklarata solemne është në bazë të nenit 36 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

